URDHËR
Nr. 393, datë 27.9.2021

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; të neneve 28 e 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar; të nenit 21, pika 5, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", dhe të nenit 73, pika 2, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor për procedurat e prokurimit, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Sekretarit të Përgjithshëm.
2. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm.
4. Urdhri nr. 74, datë 11.2.2021, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca